



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|----------------------|
| Pranuar / Dorezuar Primijsen/Prodato Received/Delivety | 08. 09 | 2023 | 3 | viti god vegr. |
| Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| | 6040/2023 | | 1/6 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1001/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar i Kolegjit, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj-Demi me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1001/2023 të datës 17.07.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër Vendimit numër Nr.942/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme në çështjen juridike „Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1001/2023 e datës 17.07.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi me numër Nr.942/2023 i datës 16.06.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Sekretarja e Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, me detyrimin që e njëjta të bëjë largimin e masës disiplinore nga dosja e ankuesit si dhe të bëjë kompensimin e pagesës së ndaluar sipas Vendimit me numër Nr.942/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Punëve të Brendshme, obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të largoj nga dosja personale e nëpunësit civile si dhe regjistri përkatës masën disiplinore e anuluar si në pikën I.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës „Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare” pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 18.04.2023 ndaj tij Sekretarja e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka parashtruar kërkesë me numër Nr.518/2023 për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 18.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr.523/2023 përmes të cilit e ka aprovuar kërkesën me numër Nr.518/2023 të parashtruar nga Sekretarja e Përgjithshme për inicimin e procedurës disiplinore dhe ka pezulluar ankuesin nga detyra e tij.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 18.05.2023 ka nxjerr Vendim me numër Nr.705/2023 përmes të cilit ka bërë shtyrjen e afatit të procedurës administrative, për tridhjetë (30) ditë kalendarike duke filluar nga dita kur përfundon afati fillestar ligjor.

Pas zhvillimit të procedurës disiplinore Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 16.06.2023 ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.942/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 1, 2 nën paragrafi 1, paragrafi 3 nën paragrafi 1, 3, 7, 8 dhe 10 si dhe nenit 47, paragrafi 1 nën paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore „*Ndalim 40% e pagës për periudhën kohore gjashtë (6) mujore*”.

Ankuesi kundër Vendimit me numër Nr.942/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5261/2023 më datë 17.07.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se komisioni disiplinor me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore, gjegjësisht nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.942/2023 ka bërë interpretim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vërtetim jo të plotë të provave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse te Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 07.08.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me Vendimin me numër të protokollit 5845/2023 të datës 29.08.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1001/2023 të datës 17.07.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 17.07.2023 me numër protokollit 5261/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.942/2023 të datës 16.06.2023; Kërkesë me numër protokollit Nr.518/2023 e datës 18.04.2023; Vendim me numër Nr.523/2023 i datës 18.04.2023; Kërkesë me numër nr.595/2023 e datës 28.04.2023; Vendim për plotësimin e Vendimit me numër Nr.523 të datës 18.04.2023; Raporti i Auditimit me Kërkesë „*Administrimi dhe Menaxhimi i Hapësirës së Parkingut dhe Vizitoreve në Objektin ish Rilindja*” Nr.469 i datës 10.05.2023 me numër protokollit Nr.679 të datës 15.05.2023; Raport i Auditimit me Kërkesë Maj 2023;

Udhëzim Administrativ Nr. MSHP 2004/01 për Parkimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës dhe Institucioneve Qendrore të IPVQ; Vendim për Transferimin e Përkohshëm të Nëpunësit Civil me numër Nr.1174/2022 i datës 26.07.2022; Vendim me numër nr.579/2022 i datës 08.04.2022; Vendimi me numër A.nr.432/2022 i datës 23.06.2022 i Këshillit të pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimi me numër protokoll Nr.prot: 90/2016 i datës 03.10.2016; Përshkrimi i detyrave të punës; Kërkesë për leje-parkim hyrje-dalje me numër 1511/2021 i datës 15.09.2021; Kërkesë për leje parkimi me numër Nr.571-03 i datës 21.12.2022; Kërkesë me numër nr.0239-96/1 e datës 10.01.2023; Kërkesë për leje parkimi për veturat zyrtare me numër Nr.03/10235 e datës 19.12.2022; Kërkesë e datës 21.09.2021; E-mail i datës 12.04.2023; E-mail i datës 24.11.2022; E-mail i datës 18.11.2022; E-mail i datës 17.11.2022; E-mail i datës 15.11.2022; Raporti mujor-mars 2023, DSPIMNQ; E-mail i datës 13.02.2023; E-mail i datës 01.12.2022; E-mail i datës 16.11.2022; E-mail i datës 13.12.2022; E-mail i datës 04.04.2023; E-mail i datës 07.02.2023; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2019-2021; E-mail i datës 03.09.2021; E-mail i datës 31.08.2021; E-mail i datës 09.11.2021; E-mail i datës 05.11.2021; E-mail i datës 20.10.2021; E-mail i datës 15.10.2021; E-mail i datës 24.09.2021; E-mail i datës 06.01.2023, E-mail i datës 11.01.2023; E-mail i datës 10.01.2023; E-mail i datës 04.01.2023; E-mail i datës 28.12.2023; E-mail i datës 07.04.2023; E-mail i datës 06.01.2023; E-mail i datës 21.10.2021; E-mail i datës 27.08.2021; E-mail i datës 14.11.2022; E-mail i datës 03.11.2022; Raporti për zbatimin e strategjisë për akomodim të institucioneve 2008-2015; E-mail i datës 22.11.2019; E-mail i datës 18.11.2019; Raporti i Inspektimit të Punëve, Montimi i Shenjave të Komunikacionit në Parkingjet Qeveritare; Raport Mujor - Nëntor 2022 DSPIMNQ/MPB i datës 07.12.2022; Raporti mujor - Mars 2023, DSPIMNQ; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 17.07.2023; E-mail i datës 26.05.2023; Ftesë për Seancë Disiplinore e datës 26.05.2023; Procesverbal i datës 30.05.2023; Vendim me numër Nr.705/2023 i datës 18.05.2023 për shtyrje të afatit në procedurë administrative; Vendim me numër VK/2023 i datës 29.08.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në shkresat e administruara të lëndës, gjegjësisht Akt Emërimin me numër protokoll Nr.prot.90.2016 të datës 30.09.2016 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës „Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare” në Ministrinë e Administratës Publike, tani në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimi me numër Nr.942/2023 i datës 16.06.2023 përmban interpretim të gabueshëm dhe jo të plotë të dispozitave ligjore gjithashtu edhe vërtetim jo të plotë të provave materiale, Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar Vendimin e Komisionit Disiplinor përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore, duke i shqiptuar masën disiplinore „Ndalim 40% e pagës për periudhën kohore gjashtë (6) mujore”, me arsyetimin për shkak të mos përmbushjes së detyrës zyrtare, mos zbatimin e dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe shkeljen e detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, e që ndërlidhen me mundësimin e keqpërdorimeve nga zyrtari z. i cili ka shfrytëzuar parkingun e Ministrisë së Punëve të Brendshme për përfitime personale dhe pa autorizim.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45 më të cilin është përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*.

Nenit 46 më të cilin është përcaktuar se: *"... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar."*

Nenit 47 paragrafit 1 më të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*.

Nenit 48 më të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore *"1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil."*

Nenit 50 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar se: *"1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit"*.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, Kolegji ka analizuar Vendimin me numër Nr.942/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor dhe ka konstatuar se ndërlidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar përshkrimin e detyrave të punës për pozitën të cilën e ushtron ankuesi si *„Drejtor i Departamentit për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare"* ku ndër të tjera ka përcaktuar se detyrat kryesore për këtë pozitë janë se: *Udhëheqë dhe mbikëqyrë procesin e koordinimit mes ministrive dhe Departamentit në fushën*

e Shërbimeve të Inxhinjeringut , menaxhimit të ndërtesave dhe objekteve si dhe kërkesave të gjeneratorëve; Vlerëson dhe vëzhgon kapacitetin e kompanive vendore dhe furnizuesve të regjistruara që ofrojnë shërbime të inxhinjeringut dhe menaxhimit të objekteve për Qeveri; Mbikëqyrë dhe udhëheqë planifikimin e programit të buxhetit dhe shpërndarjen efektive të tij dhe aktiviteteve financiare të Departamentit; Këshillon ministritë mbi qasjen e inxhinjeringut, menaxhimit të objekteve dhe çështjeve emergjente; Jep udhëzime për ministritë mbi menaxhimin e projekteve të inxhinjeringut dhe renovimin e onlekteve si dhe projekteve shërbyese , varësisht nga resurset; Mbikëqyrë marrëveshjet me qira, shpenzimet e shërbimeve komunale dhe pagesave të kryera nga institucioni; Mbikëqyrë dhe menaxhon bartjen e ministrive në objektet përkatëse duke mundësuar transferimet e tilla; Kujdeset për raportimet rreth punës së departamentit, kujdeset për aftësimin dhe trajnimin e rastit si dhe kryen edhe detyra tjera të rëndësishme, sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa raporton drejtpërdrejtë tek Sekretari i Përgjithshëm. Mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se sipas formularit të përshkrimit të detyrave të punës ankuesi nuk është përgjegjës për kontrollimin e parkingjeve e gjithashtu edhe lejimin e qasjes në parking e ka bërë Policia e Kosovës duke e kontrolluar paraprakisht validitetin e lejes, si dhe në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi ka lëshuar lejet për parking e gjithashtu për sa i përket Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/01 për Parkimin e Automjeteve të Qeverisë së Kosovës dhe Institucioneve Qendrore të IPVQ, i cili është i vjetër në bazë të shkresave të lëndës e konkretisht E-mailave zyrtar ankuesi ka kërkuar ndryshimin e udhëzimit mirëpo nuk ka marr asnjëherë konfirmim nga institucioni. Ndërlidhur me të gjitha faktet e lartë cekura Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e bazuar.

Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji vlerëson së Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e shpalljes përgjegjës të ankuesit për shkelje disiplinore sipas nenit 46, paragrafi 3, nën paragrafi 3.9 dhe 3.10; të Ligjit Nr.06-L -114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka arritur të ofroj dëshmi bindëse së janë përmbushur në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit". Dhe po ashtu në vlerësimin e Kolegjit, Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "ndalimi 60% e pagës për periudhë gjashtë (6) muaj", nuk ka marrë për bazë edhe parimin e individualizimit siç përcaktohet me nenin 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Përmbledhur si me sipër, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton së një akt administrativ i nxjerrë me shkelje procedurale dhe në kundërshtim më dispozitat materiale është akt i paligjshëm, andaj, në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1001/2023

Kaltrina Avdullaçi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ;
- Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

